

	PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS		F-113
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Ekspert/e për ofrimin e mbështetjes në realizimin e podkastit me temë <i>“Të lexuarit sistematik brenda shkollës në funksion të zhvillimit të shkathtësive të leximit / mendimit kritik”</i> dhe hartimin e raportit analitik përkatës pas podkastit.
Kodi i procedurës së rekrutimit	IDEA-08
Emërtimi i projektit	Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit / Innovating Development in Education Advancement – IDEA 2022
Kodi dhe emërtimi i aktivitetit	IDEA ZB. 16 – Realizimi i podkastit për fushën e arsimit
Numri i ditëve të punës	Deri në 5 ditë pune
Periudha e angazhimit	5 nëntor 2022 – 30 nëntor 2022

Qëllimi i konsulencës

Qëllimi i kësaj konsulence është ofrimi i ekspertizës drejt realizimit të podkastit me temë *“Të lexuarit sistematik brenda shkollës në funksion të zhvillimit të shkathtësive të leximit / mendimit kritik”* dhe hartimi i raportit analitik mbi bazën e përmbajtjes së diskutimeve aty.

Ky podkast synon të analizojë çështjet për avancimin e raportit të fëmijëve me librin dhe të mirëkuptuarit e asaj që lexojnë. Pjesëmarrësit në diskutim janë njohës të sektorit të arsimit dhe ekspertë të fushës e aspekteve të ndërlidhura. Diskutimi mëton të nxjerrë në pah shkaqet dhe arsyt e gjendjes aktuale të paraqitura nga rezultatet e nxënësve në fushën e leximit të testit PISA, dhe synon të nxjerrë rekomandime lidhur me mënyra konkrete të adresimit të tyre.

Diskutimi i zhvilluar në podkast do të përmbledhet në formën e një raporti analitik, ku të theksohen pikat më të rëndësishme dhe idetë e dala për trajtimin e këtyre sfidave në fushën e arsimit në Kosovë.

Përshkrimi i projektit

Projekti një-vjeçar *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit / Innovating Development in Education Advancement – IDEA 2022* financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Ky program është pjesë përbërëse e Strategjisë së KEC 2020-2024, dhe si i tillë synon të përmirësojë cilësinë dhe llogaridhënien përmes avokimit dhe përfshirjes në politikëbërje, monitorimit të zbatimit të politikave, realizimit të hulumtimeve në fushën e arsimit, si dhe organizimit të diskutimeve publike.

Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

Qëllimi i konsulencës është ofrimi i ekspertizës drejt realizimit të podkastit dhe hartimit të një raporti analitik mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga diskutimet në podkastin me temë *“Të lexuarit sistematik brenda shkollës në funksion të zhvillimit të shkathtësive të leximit / mendimit kritik”*. Angazhimi përfshin aktivitetet në vijim:

- Zhvillimi i planit të punës për realizimin e podkastit në bashkëpunim me Menaxherin e Projektit;
- Moderimi dhe mbikëqyrja e ecurisë së podkastit dhe diskutimeve;
- Hartimi i raportit analitik mbi bazën e të dhënave nga diskutimi në podkast.

Rezultatet e pritshme

- Përmbledhje dhe analizë e përmbajtjes së diskutimeve në podkast;
- Mbledhja e të dhënave sasiore dhe cilësore, varësisht nga tema e podkastit;
- Hartimi i raportit analitik rreth debatit në podkast.

Kualifikimet

- Kualifikim i nivelit baçelor, preferohet niveli master, në fushën e shkencave sociale, të edukimit, komunikimeve e të ngjashme;
- Njohje e dëshmuar e sektorit të arsimit në Kosovë dhe e çështjeve që kanë të bëjnë me nxënësit dhe mësuesit në nivelin parashkollor;
- Njohje ose përvojë me platforma të ndryshme mediatike në realizimin e editorialeve / reportazheve dhe/ose në produksion të podkasteve;
- Njohuri të metodave themelore të hulumtimit në shkencat shoqërore;
- Përvojë të mëhershme në hartimin e raporteve dhe editorialeve në fushën e arsimit;
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe angleze;
- Shkathtësi të mira të komunikimit dhe prezantimit të të gjeturave nga raportet.

Raportimi

Konsulenti/ja i raporton Menaxherit të Projektit.

Dokumenti duhet të dorëzohet në formë elektronike (në formatin Ms Word, fonti Times New Roman, madhësia e fontit 12), në gjuhën shqipe ose angleze.